



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA EKONOMIKE**

Nr. 60 prot.

B.Curri, më 11/12 / 2025

P.VENDIM

PËR

**“MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE
SOCIALE ME QIRA DHE SUBVENCIONIMIT TË QIRASË”**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; nenit 2 pika 45, nenit 3, 15,16 germa “ç”, 77 pika 10 të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar sipas ligjit nr 48/2023. V.K.M-së 384 dt 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore”; VKM 362 date 29.05.2019. “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qerasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”. si dhe urdherit Nr.319 Date 12.11.2025, të ngritur nga Kryetari i Bashkisë “Për krijimin e komisionit të strehimit” pas diskutimeve vendosi të propozojë Keshillit Bashkiak për mbledhjen e tij të datës ____/ ____/ 2025

VENDOSI

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak të miratojë vlerat e banesave me qera për bonuset e strehimit si me poshtë;

**TABELA E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE
SOCIALE ME QIRA**

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikë
1.1	Kushtet e strehimit	30
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi	10
B	Banojnë në banesa rrezik shembjeje	8
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	5
Ç	Kanë mbetur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore ose i zbatimit të një vendimi gjyqësor	7
1.2	Kushtet familjare	20
A	Familjet e policëve të rënë në detyrë	5

B	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk për zgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore	5
C	Familjet me më shumë se 4 fëmijë ose familje njëprindërore	5
Ç	Familje të minoriteteve Rome dhe Egjiptiane	5
1.3	Kushtet sociale	20
A	Persona me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave	8
B	Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç	6
C	Emigrant i rikthyer, punëtor emigrant	2
Ç	Viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit	4
1.4	Kushtet ekonomike	30
A	Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare	15
B	Të ardhura deri 80% - 100% të të ardhurave mesatare	10
C	Të ardhura 100% - 120% të të ardhurave mesatare	5

Shënim

Pikët maksimale që mund të përfitojë një familje janë 100. Nuk mund të mbledhen brendapërbrenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në Ç të kriterit 1.1;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2; dhe
3. Nga A deri në C të kriterit 1.4.

Pikët nga A deri në Ç të kriterit 1.3 mund të mbledhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

1. Pika A mund të mbledhet me njërin prej rasteve si më poshtë:

a) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;

b) Vetëm me pikën C;

2. Pika B mund të mbledhet vetëm me pikën A.

3. Pika C mund të mbledhet vetëm me pikën A.

4. Pika Ç mund të mbledhet me pikat A e B së bashku ose me njërin prej tyre.

Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.

2. Ngarkohet Komisioni i Strehimit Bashkiak Tropoje, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi (dhjetë) ditë pas mbledhjes

Konceptoi: Specialisti i Strehimit
B. Buçpapaj

Pranoi: P. Sek. Ndekonomike dhe Mbrojtjes Sociale
Sh. Gjoka

Ligjishmeria

KRYETARI
Rexhe BYBERI